



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:054019

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513902

P.nr.74/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi me pjesëmarrjen e procesmbajtëses praktikante Rejhane Mani në çështjen penale kundër të pandehurit G.M, nga komuna Kastriot, për shkak te veprës penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1472/21 të datës 08.03.2022, jashtë seancës, në mbështetje të nenit 248, par. 1, nën par. 1.4, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësim, me datë 27.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr. Ref. ND.53/2024 e datës 27.03.2024 e arritur ndërmjet të pandehurit G.M dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar “N...”, N.I.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1472/21 e datës 08.03.2022.

III.PUSHOHET procedura penale për të pandehurin G.M, i lindur me datë ..., ne Prishtine, tani me vendbanim në Fushe Kosove, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1472/21 të datës 08.03.2022, e ka akuzuar të pandehurin G.M, nga komuna Kastriot, për shkak te veprës penale *Vjedhja* nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 20.03.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilën i pandehuri ka kërkuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, pasi që është i gatshëm të bëjë kompensimin e dëmit, e po ashtu edhe prokurorja e shtetit është pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit. Andaj gjykata ka referuar këtë lëndë penale në ndërmjetësim pasi që me nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, e që në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është përcaktuar dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët me datë 27.03.2024, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim ashtu që janë pajtuar që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata duke pasur parasysh marrëveshjen e arritur në ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, e bazuar në neni 357 par. 1, pika 1.3 ka vendosur si në dispozitiv të pikës 2 dhe 3 të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.74/2022, datë 27.03.2024

Procesmbajtëse - Praktikante
Rejhane Mani

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa (neni 229 par. 6 të KPP-së).